



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA IV

Sesioni pranveror

Komisioni për Bujqësi, Pylltari, zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor

Mbledhja nr. **68**

Prishtinë, më 7.5.2012, ora 11,00

Ndërtesa e Kuvendit, sala N-225

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT

Në mbledhje morën pjesë: Nait Hasani, Liburn Aliu, Rasim Demiri, Nijazi Idrizi, Sevdije Lama, Afërdita Berisha-Shaqiri, Salih Morina.

Mungoi : Daut Haradinaj, Etem Arifi.

Të ftuar dhe pjesëmarrës tjerë: zyrtar, bashkëpunëtor, përfaqësues dhe vëzhgues të interesuar (ICO, KDI, OSBE, Presidenca, NDI-Shefki Kastrati) dhe media.

Stafi mbështetës i komisionit: Bajram Badivuku, Ylber Sherifi.

Mbledhjen e kryesoi **Nait Hasani**, kryetar i komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës ;
2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së komisionit, të mbajtur më 30.4.2012,
3. Raporti vjetor i plotësuar nga ZRRUM,
4. Të ndryshme.

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 30.4.2012

Kryetari konstatoi se Komisioni miratoi Procesverbalin e mbledhjes së mbajtur më 30.4.2012.

3. Raporti vjetor nga ZRRUM

Kryetari Nait Hasani përshëndeti drejtorin nga ZRRUM z. **Raif Preteni** nga i cili kërkoi sqarime rreth raportit të plotësuar. Drejtori i ZRRUM japi sqarimet shpesh me interesimin e

deputetëve nga data 2 prill për pagesat e ujit dhe shtoi se që nga data 30 qershor 2012 nuk ka me pas regjistrime paushall për obliguesit sa i përket pagesës së ujit dhe do të ketë gjoba, mirëpo ky obligim patjetër do të ketë disa sfida, mendohet se 97% të shfrytëzuesve të ujit do të kanë ujëmatësin (orën e ujit), përndryshe ai potencoi se në Kosovë (sikurse edhe në çdo vend) humbja e ujit arrin 61%-shin duke pasur parasysh keqpërdorimet dhe vjetërsimin e gypave. **Afërdita Berisha** pyeti pse diku diku paushalli është tejte i lartë, në çka reagoi z. Raif se ato raste duhet të kontrollohen. Banesat ku nuk ka ujëmatës, shënohen numri i banorëve. **Sevdije Lama** (pyeti rreth paushallit në Gjakovë), **Liburn Aliu** (pyeti a ka me pas mjaft ujëmatës për pajisje), **Nijazi Idrizi** (pyeti pse janë humbjet 61% dhe për deponin në Gjilan), **Salih Morina** (pyeti rreth auditimit gjeneral), **Nait Hasani** (pyeti rreth ujit të papijshëm tek Hidrodrini) në vazhdim bashkëbiseduan me zyrtarin e ZRRUM i cili u përgjigj në pyetjet e parashtruara dhe shtoi se aty ku nuk pihet uji, merret licenca deri sa të riparohet ndërsa qytetarët mbrohen nga shpenzimet, megjithatë kjo është kompetencë e Institutit për Shëndetësi të tregoi se ku nuk pihet uji. Ai në fund i dha edhe ca sqarime shtesë, ndërsa Komisioni kërkoi që kjo zyre mundësisht të dërgoj një raport (njoftim) për rastin e Hidrodrinit dhe Klinën, ndërkaq rreth raportit vjetor nxori :

REKOMANDIM

Rekomandohet Kuvendit të Kosovës të miratoi në mbledhjen plenare Raportin vjetor për vitin 2011 nga Rregullatori për Ujëra e Mbeturina.

4. Të ndryshme

Kryetari në këtë pikë sugjeroi disa çështje për të cilat komisioni u pajtua si vijon :

1. Të kërkohen sqarimet nga ministria përkatëse rreth një kërkesë të shoqatës së Bletarëve, e cila ka arrit në adresë të këtij komisioni, ndërsa nga Ministria e Tregtisë të kërkohet njoftimi për cilësinë e naftës në Kosovë,
2. **Projektligji për Mbeturina** konfirmohet për leximin e dytë pasi që ka përfunduar shqyrtimi edhe nga komisionet e përhershme,
3. **Projektligji për Agjencinë e Rrezatimeve** gjithashtu konfirmohet për leximin e dytë me përmirësime teknike të miratuara tek neni 1, neni 2, neni 4, neni 7, neni 9 dhe të fshihet neni 21. Liburn Aliu kishte vërejtje rreth titullit të Ligjit dhe mënyrës së shqiptimit të “dhe Siguria Bërthamore”, ngase nuk mund të thuhet p.sh. “mbrojtja nga rrezatimet dhe sigurisë bërthamore”, por “mbrojtja nga rrezatimet dhe siguria bërthamore”.
4. Të martën më 8 maj komisioni mban mbledhjen për projektligjin e Ndërtimit ku do të ftohet Ministri i MMPH dhe parashtruesit e vërejtjeve.
5. Pasi që financuesit e **vizitës së komisionit në Gjeorgji** anulojnë mundësinë për këtë vizitë, në mbledhjen e nesërme komisioni përfundimisht me donatorin do të përfundoj çështjen e vizitës me zëvendësimin me një vizitë tjetër në një shtet tjetër, ngase ky rast me këtë projektligj kërkon përvojë konkrete si vepohet me ndërtimet në Kosovë.

Mbledhja përfundoi në orën 12,25.

Përgatitur nga:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit,

Nait Hasani

